

ANEKSI 7

ZBATIMI I PARIMEVE TE KONTABILITETIT PERGJITHESISHT TE PRANUARA PER PERCAKTIMIN E VLERES DOGANORE.

1. Me “parime përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit” do të kuptohen të gjitha rregullat apo normat e njohura dhe të pranuar apo të vendosura në një vend të caktuar dhe në një moment të caktuar

që përcaktojnë se cilat nga burimet ekonomike dhe detyrimet duhet të regjistrohen si asete (aktive) dhe likuiditete (pasive), si maten asetet dhe likuiditetet dhe ndryshimet që bëhen në to, cfarë informacioni duhet të publikohet dhe në ccmënyrë duhet bërë një gjë e tillë dhe cfarë raportesh (bilancesh) duhet të përgatiten. Rregullat mund të konsistojnë në parime dhe udhëzime të përgjithshme për zbatim por edhe në formën e praktikave dhe procedurave të hollësishme.

2. Per qellime te zbatimit te dipozitive që lidhen me vleresimin doganor, administrata doganore duhet te shfrytëzojë informacionin, e përgatitur ne përputhje me parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit te pranuar ne vend, qe eshte në përputhje me pikën përkatëse. Per shembull, percaktimi i fitimit te zakonshem dhe shpenzimet e pergjithshme sipas dispozitave te pikës 64 (1) (a) (i) te ketyre dispozitave zbatuese do te bëhet duke perdorur informacionin e përgatitur në përputhje me parimeve përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit ne Republikën e Shqipërisë. Nga ana tjeter percaktimi i te ardhurave te zakonshme dhe shpenzimeve te pergjithshme sipas akteve nenligjore te nenit 35 (2) (d) te Kodit mund te kryhet duke perdorur informacionin e përgatitur ne përputhje me parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit në vendin e prodhimit. Si nje shembull i metejshem, percaktimi i nje elementi ne baze te nenit 37 (1)(b)(ii) te Kodit qe është kryerr në Republikën e Shqipërisë duhet te kryhet duke shfrytëzuar ne menyre te vazhdueshme parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit ne Republikën e Shqipërisë.